L I G J
Nr.8627 datë 22.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHTESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN "MBËSHTETJE PËR HEDHJEN E BAZAVE TË VEPRIMTARISË SIPËRMARRËSE""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për shtesën e financimit për projektin "Mbështetje për hedhjen e bazave të veprimtarisë sipërmarrëse"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2671, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE HUAJE

Në bazë të notave të shkëmbyera ne 4 maj 1994, midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës Shqiptare (Notat I) në respekt të zbatimit të fondit të kredisë ripërtëritëse (Fond Kredie) dhe të Fondit të Garancisë në kuadrin e projektit "Promovimi i Veprimtarisë Sipërmarrëse në Shqipëri"(Projekt), Deutsche Ausgleichsbank (DtA) dhe Banka Agrare (RCB) mbyllën më 20 qershor 1995, një marrëveshje huaje duke përfshirë nje direktivë për zbatim ("Marrëveshja Origjinale e Huasë").

Që nga 1 prill 1999 DEG u caktua nga Bundesministerium fur wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung ("BMZ") në vend të DtA për të vepruar si agjentë i vetëm ekzekutiv, si përfaqësues i Qeverisë Gjermane brenda kuadrit të përshkruar.

Sipas ligjit nr. 8393 i datës 30 prill 1998 dhe dekretit nr. 2085 i datës 12 maj 1998 Agjensia per Administrimin e Kredive (ATK) u krijua si trashëgimtar i ligjshëm i RCB- së.

Në 25 maj/17 qershor, 1999 ATK dhe DEG nënshkruan një Amendament (Amendament të marrëveshjes origjinale të huasë (Marrëveshja Origjinale e Huasë dhe Amendamenti që këtej e tutje formojnë Marrëveshjen e Huasë") sipas të cilës të dyja palët bëhen palët e reja kontraktuese dhe ekskluzive të Marrëveshjes Origjinale të huasë. Më 28 Tetor 1999, të dyja palët firmosën një Marrëveshje e cila zëvendëson Marrëveshjen e Huasë.

Nga ana e Qeverisë Shqiptare Ministria e Financave është institucioni kompetent për Projektin në fjalë.

Sipas letrës së datës 31 gusht 1999, Ministria e Financave deklaroi se është dakort me Notën e datës 17 mars, 1999 (Nota II) sipas së cilës Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakort për një zgjerim financiar të projektit.

Në përputhje me Marrëveshjen Origjinale të Huasë dhe një marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Europian për kanalizimin e fondeve të dhuruara nga EU – PHARE brenda kuadrit të promovimit të SME-ve nëpërmjet Ministrisë së Financave nga Banka e Kursimeve dhe

RCB, një tjetre agjensi ndërmjetëse financiare, Qeveritë Shqiptare dhe Gjermane ranë dakort për t'ia transmetuar ekzekutimin e mëtejshëm të Projektit BIA-s. Pra, BIA, DEG dhe Ministria e Financave bien dakort në lidhje me Marrëveshjen e Re te Huasë.

BIA është shoqëri anonime e themeluar sipas ligjeve të Republikës Shqiptare me zyrë të regjistruar në Shqipëri; nëpërmjet aktiviteteve të saj BIA ekzekuton shërbime bankare komerciale. DEG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë me zyrë të regjistruar në Belvederestrasse 40,50933 Koln; qëllimi i saj është inkurajimi i investimeve private për zhvillimin edhe të vendeve të tjera partnere.

Neni 1
Shuma dhe Qëllimi i Huasë

1. Në përputhje me Marrëveshjen Origjinale të Huasë midis DtA dhe RCB-së, DEG do t'i japë hua BIA-s si hua të shlyeshme, kontributin gjerman ende të pa disbursuar në Fondin e Kredisë, shumën prej

2,876,942 DM

(me fjalë: dymilion e tetëqindeshtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e dy marka që këtej e tutje do të quhet ("huaja")

Në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të Notave të I, huaja do të përdoret në mënyrë ekskluzive për specialistët e kualifikuar shqiptarë për ngritjen e bizneseve të tyre, e preferueshme për ata specialistë që kthehen nga Republika Federale e Gjermanisë ose që janë kthyer pas 1 janarit 1993, dhe që kanë qëndruar për disa vite në Gjermani për t'u trajnuar ose si të punësuar ("Të kthyerit").

2.Në përputhje me Marrëveshjen Origjinale të Huasë shuma e huasë prej 2,123,058 DM është disbursuar nga DtA tek RCB si kontribut gjerman për krijimin e fondit ripërtëritës të kredisë. Sipas Marrëveshjes, Neni 5 të gjitha pagesat nga shpërbërja e Fondit të Kredisë së përmendur nga ATK tek DEG do të kalojnë menjëherë nga DEG tek BIA. Kështu, DEG do t'i japë hua në vazhdim BIA-s fondet e Kontributit Gjerman si hua të shlyeshme shumën prej:

2,123,058 DM

(me fjalë: dymilion njëqindenjëzetetremijë e pesëdhjetë e tetë)

(Gjendja e Huasë)

Gjendja e Huasë do të përdoret për t'iu dhënë hua specialistëve shqiptarë të kualifikuar rezidentë në Shqipëri për ngritjen e bizneseve të tyre (Të kthyerit dhe specialistët shqiptarë të kualifikuar tani quhen "Huamarrësit Finalë")

Huaja dhe Gjendja e Huasë, së bashku formojnë shumën 5.000.000 DM- (me fjalë: pesë milion marka) e që tani do të formojnë "Kontributin e Parë Gjerman ".

3.Për të finalizuar përmbajtjen e Notave të II, DEG do t'i japë hua tjetër BIA-s si hua të shlyeshme shumën prej

5.000.000 DM

(me fjalë: pesëmilion marka) ("Huaja e Dytë Gjermane")

Në përputhje me paragrafin 1. Të Notave të II, Huaja e Dytë Gjermane do të përdoret në mënyrë ekskluzive në ngritjen e bizneseve për të Kthyerit.

4. Duke iu referuar paragrafit 1, paragrafit 3, kontributi total Gjerman në Fondin e Kredisë i përmendur në paragrafin 6, më poshtë, që përfshin shuma deri në një maksimum prej 10.000.000 DM, - (me fjalë: dhjetëmilion marka) ("Kontributi Gjerman") do t'i jepen hua BIA-s nga DEG sipas Marrëveshjes së re të Huasë.

5. Duke u bazuar tek Nota I, Ministria e Financave ka disbursuar tek RBC- ja shumën prej 1,525,478 DM nga kontributi shqiptar prej 5,000,000 DM – (me fjalë: pesëmilion marka) në Fondin e Kredisë.

Duke u bazuar tek marrëveshja Neni 5, të gjjitha pagesat nga Fondi i Kredisë së shpërbërë nga ATK tek DEG do të kalojnë menjëherë nga DEG për tek BIA. Kështu, DEG do t'i disbursojë këto lloj fondesh të transferuara nga pala shqiptare (kontributi shqiptar e konkretisht nga Ministria e Financave) si një hua të shlyeshme BIA-s në shumën prej

1,525,478 DM

(me fjalë: njëmilion e pesëqindenjëzetepesë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë marka)

6. Brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive, Ministria e Financave

do të vendosi me BIA-n për gjendjen e kontributit Shqiptar ende të padisbursuar në Fondin e Kredisë, sipas Notave I, si hua e shlyeshme në shumën prej:

3,474,522 DM

(me fjalë: tre milion e katërqindeshtatëdhjete e katër e pesëqind e njëzetedy marka)

Të dyja pagesat e përmendura më lartë konsiderohen si Kontribut Shqiptar ("Kontributi i Parë Shqiptar") në Fondin e Kredisë e kanë si qëllim ngritjen e bizneseve të Huamarrësve Finalë.

7.Duke u bazuar tek Nota e II dhe tek Huaja e Dytë Gjermane, Ministria e Financave do t'i transferojë BIA-s kontributin shqiptar shtesë në Fondin e Kredisë si Hua të shlyeshme shumën prej:

2,500,000 DM

(me fjalë: dy milon e pesë mijë marka) ("Kontribut i Dytë Shqiptar")

Kontributi Total Shqiptar në Fondin e Kredisë i përmendur më poshtë në paragrafin 6 poshtë përmbledh shumën në një maksimum prej 7,500,000 DM- (me fjalë: shtatë milion e pesëqindmijë marka) ("Kontributi Shqiptar"), i cili do t'i jepet hua BIA-s nga Ministria e Financave sipas Marrëveshjes.

Kontributi Shqiptar do të përdoret për ngritjen e bizneseve të Huamarrësve Finalë dhe nga Kontributi Shqiptar të paktën 51% do të përdoren për t'iu dhënë hua të Kthyerve për ngritjen e bizneseve të tyre.

8. Vendimet në lidhje me dhënien e huave që do t'ju jepen Huamarrësve Finalë për ngritjen e bizneseve të tyre, do të merren në përputhje me praktikat bankare ndërkombëtare dhe termat e biznesit të BIA-s.

Neni 2

Kushtet e huasë dhe shlyerja

1. BIA do të paguajë interesin prej 0.75 në vit (zero pikë shtatëdhjetë e pesë) për të gjitha shumat e disbursuara BIA-s dhe shumat e tërhequra nga BIA. Interesi debitohet në shumën përkatëse deri në ditën kur shlyerjet kreditohen në llogaritë e përmendura në nenin 9, paragrafi

2. Huatë (Huaja e Parë Gjermane, Huaja e Dytë Gjermane dhe Kontributi Shqiptar) do të kenë një afat prej 40 vjetësh, duke filluar që nga dita në të cilën huaja individuale disbursohet, ose shuma e parë e pjesshme e huasë individuale disbursohet. Dhjetë vitet e para do të jenë periudhe grace. Pas kësaj, huatë do të kthehen në 60 transha të barabarta dy herë në vit. Shumat e transhave do të përcaktohen 6 muaj para datës së parë të vlefshme. Programi i shlyerjes do të rregullohet në rastin e shlyerjes ose e shlyerjes së parakohshme ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 8. dhe nenin 4, paragrafi 4.

1. Data e disbursimit të parë të Huasë së Parë Gjermane siç specifikohet në paragrafin 1 dhe 2 do të jetë 14 gusht1996.

2. Data e disbursimit të huasë së Dytë Gjermane siç specifikohet në paragrafin 1 dhe 2 dhe të jetë dita e disbursimit të huasë ose dita e disbursimit të parë të pjesshëm që debitohet në llogarinë e DEG-ut të specifikuar në nenin 9 paragrafin 1.

3. Data e disbursimit të Kontributit të Parë Shqiptar siç thuhet në paragrafin 1 dhe 2, është 5 nëntor 1996.

4. Data e disbursimit të Kontributit të Parë Shqiptar siç thuhet në paragrafin 1 dhe 2, është dita e disbursimit të huasë ose e disbursimit të parë të pjesshëm që debitohet në llogarinë e Ministrisë së Financave e specifikuar në nenin 9 paragrafin 1.

5. Pagesat e interesave dhe të principalit do të bëhen dy herë në vit për periudhën deri në 30 qershor ose 31 dhjetor çdo vit.

6. BIA mund ta shlyejë përpara huanë të plotë ose të pjesshme.

7. Ministria e Financave dot'i japw hua BIA –s Kontributin Shqipar të përcaktuar në nenin 1 paragrafi 5 në mënyrë ekskluzive sipas kushteve dhe afateve të Marrëveshjes së Re të Huasë.

Neni 3

Procedurat e disbursimit dhe njoftimi për disbursim

1. Pas marrjes së një njoftimi të shkruar nga BIA, DEG do të disbursojë Huanë e Parë Gjermane dhe Huanë e Dytë Gjermane të pjesshme ose të plotë në llogarinë e hapur nga BIA në

Republikën Federale të Gjermanisë për këtë qëllim.

Në të njëjtën mënyrë, pas marrjes së njoftimit të shkruar nga BIA, Ministria e Financave do të disbursojë Kontributin e Parë Shqiptar dhe Kontributin e Dytë në llogarinë e hapur nga BIA në Republikën Federale të Gjermanisë për këtë qëllim.

BIA duhet të informojë DEG dhe Ministrinë e Financave për numrat e llogarive dhe të kodeve bankare para njoftomit të parë për disbursim.

2. BIA-s i lind e drejta për të kërkuar shumat e huasë nga DEG, kur shuma e tërhequr nga Ministria e Financave sipas klauzolës 5, paragrafit 1a) të Notave të II është transferuar në llogarinë e BIA-s dhr shumat që kërkohen mund t'i kalohen Huamarrësve Përfundimtar maksimumi brenda 2 muajve kalendarikë nga marrja e parave nga BIA.

3.BIA-s do t'i kalojë shumat e kërkuara për tek Huamarrësit Përfundimtarë pas paraqitjes së kontratave të blerjes, faturave ose dokumentave të tjera, kopjet e të cilave duhet të ruhen në dosjet e kredive. Në përputhje me nenin 11 (4) BIA duhet të informojë DEG për datën e cdo kalimi të shumave për tek Huamarrësit Përfundimtarë.

4. Nëse BIA nuk është në gjendje të kalojë një shumë të kërkuar para skadimit të afatit në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 dhe 3, te specifikuara në paragrafin 2, shumat e tilla duhet t'i kthehen mbrapsht DEG ose Ministrisë së Financave pa humbur kohë. Kjo klauzolë nuk i referohet Gjendjes së Huasë dhe Kontributit të Parë Shqiptar. Nëse shfaqen rrethanat e nenit 5 paragrafit 13, BIA do të kërkojë kthimin e fondeve nga Huamarrësit Përfundimtarë e do t'i dërgojë mbrapsht DEG dhe Ministrisë së Financave.

5. Së bashku me njoftimin e parë për disbursim BIA duhet të konfirmojë që të gjitha kërkesat janë përmbushur në përputhje me ligjet Shqiptare si dhe për të gjitha detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje. Kjo duhet të zbatohet në veçanti, duke respektuar rregullat e këmbimit valutor.

6. BIA duhet të informojë DEG dhe Ministrinë e Financave për emrat e personave që janë të autorizuar për ta përfaqësuar në ekzekutimin e Marrëveshjes, si dhe prova për firmat e tyre. Autorizimet e humbasin vlerën vetëm pasi DEG dhe Ministria e Financave i mohojnë ato.

7. Detyrimet që kanë DEG dhe Ministria e Financave sipas Marrëveshjes së Re të Huasë janë shumë të disponueshme nga Buxheti i Shtetit.

8.DEG dhe Ministria e Financave kanë të drejtë të refuzojnë disbursimet e shumave të kërkuara n.q.s:

a) BIA nuk përmbush detyrimet e shlyerjes kundrejt DEG dhe Ministrisë së Financave në datën e duhur, ose

b) BIA nuk përmbush detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje, ose

c) BIA nuk mund të konfirmojë që shumat e huasë tashmë të disbursuara janë përdorur në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, ose

d) Shfaqen rrethana të vecanta që pa marrë parasysh diskutimet dhe përpjekjet nuk mund të korigjohen e që rrezikojnë ose parandalojnë ndjeshëm përmbushjen e detyrimeve që BIA ka kundrejt DEG dhe Ministrisë së Financave në kuadrin e Marrëveshjes së Re të Huasë.

9. Nëse shfaqet një nga rrethanat e specifikuara në paragrafin 8 e nuk zgjidhet brenda kufirit të përcaktuar nga DEG, që duhet të jetë një periudhë minimumi prej 30 ditësh, DEG dhe Ministria e Financave mund:

Në rastin e pikave a), b) dhe ose d) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të huasë së zgjatur si dhe pagesat e të gjitha interesave që lindin dhe të tjera konflikte të kësaj Marrëveshje.

Në rastin e pikës c) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave për të cilat BIA nuk mund të provojë që janë përdorur për qëllimet e duhura.

1. Disbursimi i shumave të specifikuara në paragrafin 5 të Nenit 1 duhet të kryhet në përputhje me paragrafin 1 deri 9 të këtij Neni nese nuk parashikohet ndryshe në paragrafin 5 të Nenit 1.

Neni 4
Administrimi i fondit të kredisë

1.Fondi i Kredisë do të administrohet nga BIA si një fond i veçantë dhe si i tillë duhet të administrohet veçantë nga transaksionet dhe fondet e tjera.

2. Shlyerjet (interesat dhe principalet) të paguara BIA-s nga Huamarrësit Përfundimtarë për huatë e ngritjes së biznesit të dhënë nga Huaja e Parë Gjermane, Huaja e Dytë Gjermane dhe

Kontributi Shqiptar do të kreditohen në Fondin e Kredisë. Këto shlyerje duhet të përdoren për t'iu dhënë përsëri hua specialistëve shqiptarë të kualifikuar për ngritjen e bizneseve të tyre, e do të përbëjnë bazën për ripërtëritjen e Fondit të Kredisë. Fondet e përtërira mund të përdoren edhe për specialistët e kualifikuar shqiptare që nuk kanë qëndruar në Republikën Federale të Gjermanisë.

3. Në përputhje me praktikat bankare nderkombëtare , BIA do të depozitojë në kushtet më të mira të mundshme dhe në çdo kohë stokun e kapitalit të papërdorshëm në DM ose USD. Interesi i fituar nga të tilla depozita do të kalojë tek Fondi i Kredisë pas marrjes nga BIA.

4. Në rast se Kontributi Gjerman në stokun e kapitalit të Fondit të Kredisë nuk mund të përdoret komplet ose pjesërisht sipas paragrafit 2 brenda 6 muajve në vazhdim të gjitha shumat që e kalojnë 3,500,000 DM (me fjalë: tre milion e pesëqind mijë marka) duhet t'i paguhen DEG-ut si një shlyerje principali e pazakontë. Kjo dispozitë është e vlefshme vetëm pas 1 janarit 2001.

Neni 5

Kushtet për huatë që do të përdoren për ngritjen e bizneseve

1. Kushtet e mëposhtme do të aplikohen në të njëjtën mënyrë si për Huanë Gjemane ashtu dhe për Kontributin Shqiptar dhe duhet të specifikohen në të dyja Marrëveshjet e Huasë së ngritjes së bizneseve që BIA do të firmosi me Huarmarrësit Përfundimtarë.

2. Qëllimi

Fondi i Kredisë do të përdoret nga BIA për ngritjen e bizneseve të reja kudo në Shqipëri. Huatë do të përdoren për krijimin e ndërmarrjeve private të vogla dhe të mesme ose për ndërmarrjen e aktiviteteve private në fushën e profesioneve të pavarura (free-lancer). Të përjashtuara janë biznesi ushtarak dhe të tjera aktivitete diskriminuese.

Huatë do të jenë të disponueshme për t'iu përgjigjur kërkesave financuese afatgjatë si dhe për financimin e kapitalit të përdorshëm në një raport të përshtatshëm me atë të investimeve. Kostot e fushës private të Huamarrësve Përfundimtare nuk do të financohen.

Llojet e investimeve që mund të financohen janë si më poshtë:

Ngritja e ndërmarrjeve të reja.

Ndërmarrjet e reja mund të krijohen si ndërmarrje private ose në çdo lloj formë tjetër të lejuara sipas Ligjeve shqiptare.

Ndërmarrja e firmave ekzistuese.

Në këtë rast ndërmarrësi do të marrë përsipër firmën me të gjitha aktivet e saj të prekshme dhe të paprekshme dhe të vazhdojë aktivitetin përkatës.

Partnerët aktivë në firmat ekzistuese.

Një investim aktiv merret përsipër nëse ndërmarrëse merr pjesë në drejtimin e firmës ekzistuese pa zotëruar të gjitha aksionet e firmës së përmendur.

Investimet për zgjerimin e firmave të reja.

Këto lloj investimesh mund të kryhen në fazën e krijimit të firmave psh. brenda tre viteve të para pas fillimit të biznesit.

Prioritet duhet t'i jepet financimit të krijimit të ndërmarrrjeve të reja. Në të gjitha rastet duhet të sigurohet që financuesi vë në zbatim aktivitetin e vëretë të financuesit edhe nëse financuesi merr pjesë në vendimet e ndërmarrjeve nëse është bashkautorizues për drejtimin dhe përfaqësimin dhe n.q.s. mban 25% të kapitalit të partnerëve. Për ekzaminimin e autoritetit drejtues dhe për pjesën e fitimit edhe detajet e marrëveshjes së partnerëve janë vendimtare.

BIA do të japë hua për ngritjen e bizneseve në përputhje me principet e politikës së Republikës së Shqipërisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

3. Kushtet paraprake për të aplikuar

Ata që kanë të drejtën për të aplikuar janë personat e kulaifikuar shqiptarë të cilët përsa i përket aftësisë ndërmarrëse dhe eksperiencës profesionale janë të kualifikuar për Projektin në fjalë. Prova e përfart e kualifikimit duhet t'i paraqiten BIA-s.

Financimi është i lidhur vetëm me personin.

Nëse huaja do t'i japet një njësie ligjore duhet siguruar që kërkesat e aplikimit për marrje huaje janë të përmbushura nga personi fizik që aplikon. Marrëveshja e huasë midis BIA-s dhe njësisë legale mund të mbyllet atëherë kur provohet se aplikuesi që ka aksione është gjithashtu i përgjegjshëm për detyrimet e njësisë legale me të gjitha aktivet e saj.

Huatë jepen vetëm për qëllimin “ndihmo njerëzit që të ndihmojnë vetveten”. Në këtë mënyrë duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat financare të aplikuesit.

Do të financohen vetëm ato Projekte që përshtaten me mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit dhe rregullat e sigurisë në Shqipëri. Prioritet do t’i jepen Projketeve për gratë dhe atyre për mbrojtjen e mjedisit.

Financohen vetëm ndërmarrjet e regjistruara.

Nuk ekzistojnë të drejta legale për të tilla financime.

4. Shuma e Huasë dhe pagesa

Huaja do të jepet në shumën prej 80% e kostos së investimeve përkatëse. Qëllimi i huave është financimi i një pjese të projektit. Aplikuesi duhet të marrë pjesë në financim me të gjitha fondet e tij dhe/ose me fonde nga burime të jashtme deri në një masë të përafërt – si rregull të paktën të mbulojë 20% të shpenzimeve totale të Projektit të gjykuara korrekt.

Maksimumi i huasë do të jetë 150. 000 DM.

Shuma e huasë do të varet nga karakteristikat speciale dhe funksionimi i mundshëm i Projektit të Huamarrësve Përfundimtarë, nga fondet vetjake të disponueshme si dhe nga situata financiare e aplikuesit. Plani i Biznesit dhe kapitali i përdorshëm janë të domosdoshme për ngritjen e bizneseve të reja dhe duhet të jenë në një marrëdhënie ekonomike të justifikuar nga fitimi i pritshëm BIA ruan të drejtën, nëse është e domosdoshme, të llogarisë është një herë koston e investimit total në të cilën bazohet huaja.

Pagesa do të jetë 100% nga shuma e huasë e aprovuar.

BIA ka të drejtën për të caktuar një herë interesin prej 1% për shërbimin e huasë së aprovuar.

BIA mund t’ia japë huanë ose shuma të pjesëshme furnizuesve, prodhuesve, shitësve huamarrësve të fundit etj, mbështetur në kërkesën e Huamarrësve Përfundimtarë.

5. Monedha

Huatë për ngritjen e bizneseve mund të kontraktohen në monedhë të huaj (p.sh. DM, USD, Lira italiane). Duke iu përmbajtur konvertimit të DM në monedhën përkatëse do të zbatohet kursi i këmbimit zyrtar i Bankës së Shqipërisë i ditës së disbursimit të huasë ose të shumave të pjesshme.

6. Norma e Interesit

Interesi i përcaktuar nga BIA për monedhën e zgjedhur do të jetë fiks ose i ndryshueshëm, por në çdo rast, 10% më i ulët se interesi i tregut, i cili do të rishikohet dy herë në vit nga DEG dhe BIA.

Interesi dot ë paguhet në katër transha.

7. Afati

Deri në 10 vjet.

Afati do të caktohet sipas kërkesave specifike të Projektit individual të aplikuesit. Në rast se kërkohet financimi afat-shkurtër dhe afat-gjatë mund të ndahet në nën hua me afate të ndryshme.

8. Periudha grace/Shlyerja e principalit.

Mund të bihet dakord për një periudhë grace deri në 2 vjet.

Pas kësaj, huatë mund të shlyhen me këste mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore.

Huatë mund të shlyhen parakohe komplet ose pjesërisht në çdo kohë falas, pa qenë e nevojshme njoftimi paraprak.

9. Garancitë

BIA zotohet me përgjegjësi të plotë kundrejt DEG dhe BIA-s për akordimin e huave për ngritjen e bizneseve.

BIA do të kërkojë nga Humarrësit Përfundimtarë të gjitha llojet e garancive, sigurimeve etj, që janë konvencionale të disponueshme në sistemin bankar shqiptar në mbështetje të huasë individualë për ngritjen e bizneseve.

BIA i merr në konsideratë gjithashtu edhe aplikimet në rastet kur biznesi i planifikuar si dhe mundësitë ndërmarrëse të aplikuesit konsiderohen pozitive megjithëse nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme.

Kryesisht në rastet e mungesës ose të pamjaftueshmërisë së kolateraleve 65% e disbursimit të huasë sigurohet nga Fondi i Garancisë siç përmendet në Nenin 7 dhe 8.

10. Siguritë

Huamarrësi Përfundimtar merr përsipër brenda kuadrit të marrëveshjes me BIA-n që të sigurojë mjaftueshëm në përputhje me praktikat e biznesit në Shqipëri pronën aktuale dhe të ardhshme dhe garancitë për pjesën e pasiguruar të huasë. BIA do të quhet si përftuese në dokumentat e

sigurimeve, nëse është e mundshme sipas Legjislacionit Shqiptar.

11. Procedura e Aplikimit

Aplikimet duhet të dërgohen tek BIA ose tek degët e saj. Një përfaqësues i DEG ose një nga përfaqësuesit e autorizuar, duhet të angazhohet në komitetin e kreditit konkretisht e procedimit të huasë.

Aplikimi duhet të paraqesë një vlerësim të Projektit, dhe për këtë arsye duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtme:

Curriculum Vitae në formë tabele

Kopjen e pasaportës dhe të lejes së qëndrimit në Republikën Federale të Gjermanisë (Për të kthyerit nga Republika Federale e Gjermanisë).

Trashëgimitë dhe/ose çertifikatat e aktiviteteve (p.sh. Çertifikata të trajnimit, aktivitetet profesionale).

Përshkrimi i Projektit.

Parashikimi i fitimit dhe i humbjes.

Investimi dhe plani i financimit.

Dokumentet që tregojnë financimin e vërtetë (dokumente që tregojnë burimet vetjake, marrëveshje huash etj.)

Regjistrimi i një biznesi.

Si dhe merr përsipër:

Marrëveshjen e Blerjes.

Bilanci dhe Gjendja e Fitimit dhe e Humbjes së kompanisë.

12. Kushte të Tjera

Në lidhje me dhënien e huasë për ngritjen e bizneseve të reja, humarrësi do të ketë si pikë referimi Kushtet e Përgjithshme të Bizensit së BIA-s. Para ngritjes së biznesit ose gjatë fazës së krijimit, Huamarrësi Përfundimtar mund të jetë i detyruar të marrë pjesë në seminare ose të tjera trajnime ose të ketë avantazhin e shërbimeve konsultuese të ofruara nga agjenci të përafërta. Akordimi i huave për ngritjen e bizneseve mund të të jetë i kushtëzuar nga pjesëmarrja e suksesshme.

Huamarrësi Përfundimtar duhet të japë pëlqimin e tij në kuadrin e marrëveshjes së huasë me BIA-n, se BIA lejohet të pajisë DEG me dokumente përsa i përket situatës ekonomike dhe ecurisë së biznesit. Plus kësaj, një klauzolë e njëjtë duhet të përfshihet në çdo marrëveshje huaje me Huamarrësin Përfundimtar duke iu përmbajtur Nenit 12.

13. Qëllime të Projektit

Huatë do të përdoren në mënyrë ekskluzive për qëllimet e specifikuara. Shlyerja e tyre do të kërkohet nga BIA nëse:

Huamarrësi Final ka dhënë pohime false në lidhje me fakte të rëndësishme, ose ka fshehur fakte të cilat janë vendimtare duke iu përmbajtur dhënies së huave për ngritjen e bizneseve ose

Kushtet e kërkuara për dhënien e huasë për ngritjen e bizneseve, në mënyrë të njëpasnjëshme kanë ngecur së zbatuari ose

Huaja për ngritjen e bizneseve nuk është përdorur për qëllimin e duhur, ose nëse përdorimi i huasë për qëllimin e duhur e investimet e bëra mund të mos jenë konkretizuar nëpërmjet dokumenteve të përshtatshme brenda 6 muajve nga pagesa e huasë.

Humarësi Përfundimtar refuzon të përmbushë detyrimin e tij për të siguruar informacion ose refuzon kontrollin.

Neni 6

Fondi i garancisë

1. Në përputhje me Nenin 4 para I b) të Notave të I Qeveria Gjermane u angazhua për një kontribut financiar të pashlyeshëm për krijimin e fondit të garancisë në shumën prej 1,500,000 DM – ("Fondi i Garancisë"). Në 3 shtator 1996 dhe 29 nëntor 1996, DtA ka transferuar dy kontribute financiare të pashlyeshme në shumën totale prej 1,000,000 DM e cila i është kaluar ATK-së.

Në lidhje me këtë DEG angazhohet t'i transferojë BIA-s pjesën ende të padisbursuar të këtij kontributi financiar të sapopërmendur në shumën prej

500,000 DM

(me fjalë: pesëqindmijë marka)

brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive.

2. Duke u bazuar në Notat e II DEG do t'i transferojë BIA-s në plus një kontribut të dytë financiar në shumën prej

500,000 DM

(me fjalë: pesëqindmijë marka)

brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive, duke iu referuar pëlqimit të dhënë nga BMZ-ja.

3. Duke iu referuar Marrëveshjes përkatëse pagesat nga ATK do të transferohen tek DEG për tek BIA. Pra DEG do t'i japë BIA-s fonde plus në shumën prej

1,000,000 DM

(me fjalë: njëmilion marka)

4.Kontributi financiar i përmendur në paragrafin 1 dhe 2 do të akordohet nga DEG si përfaqësues i Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë me kusht që fondet përkatëse do të jenë të disponueshme nga Buxheti i Shtetit Gjerman.

5. BIA merr përsipër të përdorë kontributin financiar si stok kapitali për krijimin e Fondit të Gjermanisë të Garancisë me qëllim që të sigurojë garanci për të gjitha huatë që do të akordohen për ngritjen e bizneseve, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Re të Huasë. BIA do të sigurojë garancitë nga Fondi i Garancisë për huatë e ngritjes së bizneseve të sapopërmendur në përputhje me Nenin 7 dhe 8 të Marrëveshjes së Re të Huasë.

Neni 7

Administrimi i fondit të garancisë

1. Administrimi i Garancisë do të trajtohet nga BIA si një fond special dhe si i tillë do të administrohet veçant nga transaksionet e tjera, fondet e tjera dhe nga ndonjë biznes tjetër. Fondi i Garancisë, nëse është e nevojshme, përfaqësohet nga BIA në marrëdhëniet e jashtme.

2. BIA do ta depozitojë stokun e kapitalit të fondit të garancisë në kushtet më të mira të mundshme në DM ose USD, në përputhje me praktikat bankare ndërkombëtare, me qëllim që të ruajë në çdo kohë stokun e kapitalit. Interesi që fitohet ng të tilla depozita do të transferohet në stokun e kapitalit brenda 3 ditë pune, pas marrjes nga BIA.

3. Sipas Nenit 5, paragrafit 6 nga interesi i paguar nga Humarrësit Përfundimtarë fillimisht një shume që i korrespondon interesi prej 0.75% në vit do të transferohet tek DEG dhe Ministria e Financave sipas Nenit 2 paragrafit 1. Nga gjendja që ngelet 20% do të kalohet te stoku i kapitalit të Fondit të Garancisë menjëherë pas marrjes nga BIA se interesit të paguar nga Humarrësi Përfundimtar. Pjesa e ngelur do të përdoret në përputhje me Nenin 16 (2).

4. Me qëllim përdorimin e Fondit të Garancisë në mënyrën më të mirë të mundshme, shuma totale e garancive të akorduara në prputhje me Nenin 8 paragrafi 2 do të jetë një multiplikator i stokur të kapitalit të Fondit të Garancisë. BIA do të mbulojë rrezikun e mbikalimit të stokut të kapitalit të Fondit të Garancisë.

5. Stoku i kapitalit i papërdorur do të ngelet tek BIA për aq kohë sa ekziston Fondi i Kredisë. Në momentin e mbylljes së Fondit të Kredisë, Ministria e Financave vendos për përdorimin e mëtejshëm të stokut të kapitalit të papërdorshëm të Fondit të Garancisë.

Neni 8

Kushtet e garancisë

1. Lloji dhe qëllimi i garancive:

Garancitë e dhëna në favor të BIA-s nga Fondi i Garancisë do të jenë garanci deficiti për të mbuluar kapitalin dhe interesin për të gjitha huatë e dhëna nga BIA për ngritjen e bizneseve të reja sipas Marrëveshjes së Re të Huasë. Defiçiti përkufizohet si diferenca midis shumave që rezultojnë nga shtrëngimi i të gjitha sigurive të disponueshme dhe shumave të detyruara BIA-s sipas marrëveshjeve individuale për ngritjen e bizneseve të firmosura nga BIA së bashku me Huamarrësit Përfundimtarë sipas dispozitave të Marrëveshjes së RE të Huasë.

Garancitë mund të tërhiqen vetëm kur gjendet gabimi pas realizimit të të gjitha garancive të tjera brenda kuadrit të mundësive ligjore.

2. Shuma e garancisë

Në princip për të gjitha huatë e ngritjes së bizneseve të reja vetëm 65% të shumave të disbursuara sigurohen me anë të garancive në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Re të Huasë. Në rastin e mospërmbushjes 10% të principalit dhe interesit të ngelur për t'iu paguar BIA-s do të mbeten nën përgjegjësinë e BIA-s pasi të rezultojë që të gjitha siguritë e vëna në dispozicion nga Huamarrësi Përfundimtar në favor të BIA-s janë realizuar. Gjendja e ngelur do të mbulohet me anë të garancive brenda kufijve të specifikuar më sipër.

Në përgjithësi, BIA nuk do të akordojë kryesisht për ato raste për të cilat nuk ka garanci të mjaftueshme dhe për rastet kur huatë e akorduara për ngritjen e bizneseve nuk janë të garantuara.

Për pjesën e huasë të garantuar nga Fondi i Garancisë, nuk është e nevojshme të sigurohen garanci nga Huamarrësi Përfundimtar as në favor të BIA-s as në favor të Fondit të Garancisë.

3. Dokumentet e Garancisë

Përveç këtyre kushteve nuk nxirret asnjë dokument tjetër garancie. Individi i Huamarrësit Përfundimtar nuk do të informohet rreth mbulimit të pjesshëm të huasë së tij nga këto dispozita.

4. Afati i Garancisë

Afati i Garancisë përkon me atë të huasë. Ndryshimet që ndodhin në afatin e huasë (p.sh. Rasti i shlyerjes së parakohshme ose zgjatja e huasë) automatikisht ndryshojnë dhe afatin e garancisë.

5. Procedura që ndiqet në rastin e falimentimit të Huamarrësit final

5.1. Përcaktimi i shkeljes së marrëveshjes

Në rast se Huamarrësi Final nuk përmbush detyrimet e tij nga kjo Marrëveshje Huaje me BIA-n dhe nga këta të fundit nuk gjendet ndonjë rrugë marrëveshje atëhere edhe huaja duhet të mbyllet, dhe të gjitha garancitë e disponueshme duhet të realizohen brenda mundësive ligjore. Pasi janë realizuar të gjitha garancitë dhe mbetet pa paguar ndonjë shumë nga principali dhe interesi atëhere BIA reklamon tek fondi i Garancisë.

5.2. Reklamimi nga fondi i Garancisë

Çdo disburswim nga Fondi i Garancisë për tek BIA kërkon pëlqimin e shkruar të DEG. Për këtë qëllim të gjitha dokumentet e nevojshme do t'i vihen në dispozicion DEG sapo të përcaktohet shkelja e marrëveshjes.

Në rastin kur Fondi i Garancisë i rimburson BIA-s reklamimin që është njohur si shkelje, kjo regjistrohet në bilancin e BIA-s në të njëjtën kohë me pagesën e Fondit të Garancisë dhe administrohet nga BIA në favor të Fondit të Garancisë që atëhere e në vazhdim. Reklamimi nuk shfaqet për kohë të gjatë në bilancin e BIA-s por mbetet si reklamim ligjor i BIA-s në favor të Fondit të Garancisë kundër Huamarrësit Përfundimtar.

BIA ka disa mundësi për të mbuluar të tilla reklamime në favor të Fondit të Garancisë:

5.2.1. Këstet: BIA dhe Huamarrësi Përfundimtar bien dakord për një program të ri të shlyerjes në rast të mosgjetjes së ndonjë zgjidhjeje. Reklamimi i Fondit të Garancisë mbetet në fuqi deri sa të gjitha interesat e grumbulluara dhe principali të jenë paguar plotësisht. Nëse është e mundur mund të negociohet për një shlyerje të pjesshme në rastin e të cilit një pjesë e huasë dhe/ose interesit jepet me koston e Fondit të Garancisë. Të tilla shlyerje kërkojnë pëlqimin e shkruar në DEG.

5.2.2. Shtyrja: Reklamimi në favor të Fondit të Garancisë kundër Huamarrësit Përfundimtar ngelet në fuqi. Megjithatë BIA për një periudhë kohe të përcaktuar – në emër të Fondit të Garancisë - heq dorë nga e drejta e kërkuar reklamim kundër Huamarrësit Përfundimtar. Në një rast të tillë huaja zhvendoset në kohë p.sh. në një afat prej tre vjetësh. Pas këtij afati, gjatë së cilës reklamimi mban interesat sipas marrëveshjes së huasë për ngritjen e bizneseve, mundësitë e shlyerjes së Huamarrësit Përfundimtar rishikohen. Në rastet pozitive të shlyerjes, mund të bihet dakord për një rinovim të shtyrjes, ose për lirimin nga detyrimi.

5.2.3. Lirimi nga detyrimi: BIA heq dorë nga e drejta e saj në Fondin e Garancisë. Kjo e drejtë hiqet nga Fondi i Garancisë dhe e drejta kundrejt Huamarrësit Përfundimtar bie. Ky lirim nga detyrimi kërkon aprovimin e shjkruar te DEG.

5.3. Administrimi i reklamimeve të shtyra

Në rastet e reklamimeve të shtyra BIA inspekton rregullisht rrethanat ekonomike të debitorit. Nëse rrethanat ekonomike të debitorit e lejojnë, mund të bihet dakord për një rregullim të shlyerjes.

Neni 9
Pagesat

1. Detyrimet e pagesës të BIA-s do të përmbushen vetëm n.q.s. dhe deri në çfarë mase, pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve, shuma respektive e së cilës do të kreditohet jo më vonë se ora lokale 9.00 a.m. në datën e duhur tek:

a) llogaria e bankës së DEG (Westdeutsche Landesbank Koln, Llogaria nr.707 16 65, Kodi Bankar 370 500 00, kodi Swift: West LB WELADE3K (me referencën tek "ELD-ALBANIA" me shënimin "Për qëllim Përdorimi") në EURO/Deutscher Mark (marka), ose:

b) llogarinë e bankës së Ministrisë së Financave (Llogaria Nr.317/1700, Banka e Kursimeve, Njësia 2, Tiranë) në EURO/Deutscher Mark (marka).

ose në llogari të tjera të njoftuara nga BIA jo më vonë se 7 ditë para skadimit të afatit të detyrimit.

2. Ngritja e kundërreklamimeve kundër reklamimeve të DEG të shfaqura gjatë kësaj marrëveshjeje dhe të drejtës së BIA-s për të refuzuar pagesat nuk është e lejueshme.

3. Sipas nenit 10 për llogaritjen e interesit dhe të dëmeve të rëna dakord për pagesat që e kanë kaluar afatin e vitit do të llogaritet me 360 ditë dhe muaji me 30 ditë.

4. Ndonjë pagesë brenda kuadrit të Marrëveshjes së Re të Huasë do të kryhet pa zbritjen e taksave, kostove e transferimit dhe e shpenzimeve publike të tjera. Çdo taksë ose shpenzim publik që shfaqet pas mbylljes dhe zbatimit të marrëveshjes jashtë fushës Gjermane të zbatimit do të përballohet nga BIA siç specifikohet edhe në Notat e I.

5. Shumat e huasë të padisbursuara ose të shlyera para afatit kreditohen kundër transhes së fundit të detyruar në përputhje me programin e pagesave, nëse nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 10
Pagesat e vonuara

1. Nëse pagesat nuk bëhen në datën e caktuar, penaliteti i interesit do të jetë 3% mbi normën bazë të interesit (Bassiszinssatz) sipas paragrafit I të ligjit Gjerman" Diskontsatz-Uberleitungsgesetz"" i vlefshëm atë ditë e i llogaritur nga dita e caktuar për t'u bërë pagesa deri në ditën aktuale. Penaliteti i interesit do të paguhet në datën tjetër të pagesës.

2. Sipas nenit 3 paragrafi 4, shumat e plota ose të pjesshme që nuk kthehen nga BIA në ditën e parë të javës së shtatë pas marrjes së parave nga BIA, do të paguhen përsëri me një ratë interesi prej 3% mbi normën bazë të interesit sipas paragrafit I të ligjit Gjerman "Diskontsatz-Uberleitungsgesetz"" i vlefshëm atë ditë.

Neni 11
Raportimi

1. BIA zotohet për të mbajtur kontabilitetin financiar dhe të shpenzimeve dhe sistemin e kontrollit dhe të raportimit për Fondin e Kredisë dhe fondin e Garancisë dhe veprimet e BIA-s në anglisht si dhe zotohet për t'i dërguar DEG raport vjetor dhe gjysëm vjetor në anglisht. DEG mund të kërkojë raporte të tjera nëse aktiviteti i BIA-s nuk kryhet ashtu siç duhet.

2. BIA do të autorizojë Auditorët e saj, sipas modelit të Aneksit 3, për të informuar direkt DEG rreth situatës tregtare dhe financiare.

3. BIA do të njoftojë menjëherë DEG në lidhje me ndonjë incident që mund të ndodhë dhe që ndikon tek gjendja financiare oe tregrare e BIA-s ose tek qëndrimi i BIA-s për të përmbushur detyrimet sipas Marrëveshjes së Re të Huasë.

4. BIA zotohet për të informuar DEG dhe Ministrinë e Financave nëpërmjet raporteve 3 mujore ose dhe më shpesh sipas kërkesave, duke iu përmbajtur gjendjes së Fondit të Kredisë duke paraqitur p.sh. pagesat e marra nga DEG dhe Autoritetet Shqiptare, disbursimet e paguara si hua për ngritje biznesi, pagesat e marra si principal, interesat, dhe interesat e fituara nga depozitimi i fondeve të papërdorura të stokut të kapitalit të Fondit të Kredisë.

Këto raporte do të tregojnë p.sh. normat referuese të tregut, përdorimin e duhur të fondeve duke iu përmbajtur qëllimit (të Kthyerit dhe specialistët vendas shqiptarë) duke përfshirë informacion

rreth kohëzgjatjes të huave të ngritjes së bizneseve, normën e interesit dhe shumën e garancive të marra, të shumave të ndryshme të huasë në përputhje me Nenin 1. BIA do t'i përpilojë këto raporte në përputhje me modelet e Aneksit 2, e cila mund të ndryshohet në një kërkesë formale të DEG.

5. Në të njëjtën mënyrë, BIA raporton rreth situatës së Fondit të Garancisë duke treguar p.sh. Pagesat e marra nga DEG, interesi i fituar nga depozitimi i stokut të kapitalit të Fondit të Garancisë si dhe garancitë e zbatuara për huatë e pjesshme ose të plota të papaguara.

6. Në përputhje me Nenin 4(3) dhe Nenin 7(2), BIA do të informojë me anë të raporteve 3 mujore rreth afateve të depozitave të stokut të kapitalit të papërdorur të Fondit të Kredisë dhe Fondit të Garancisë p.sh. Lloji i investimit, interesi, afati, monedha, bankën dhe numri i llogarisë së investimit.

7. Të gjitha transaksionet që do të raportohen si dhe informacioni rreth stokut të kapitalit të fondit të Kredisë dhe fondit të Garancisë do të konvertohen, nëse është e nevojshme, në marka me kursin përkatës zyrtar të Bankës së Shqipërisë i vlefshëm në ditën kur përfundohet transaksioni ose i vlefshëm në ditën e fundit të periudhës së raportuar. Diferencat e kursit të këmbimit do të raportohen si pikë më vete.

Neni 12
Kontrolli dhe e drejta e inspektimit

DEG, Ministria Federale e Bahkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe Zyra Federale Kontroluese e Republikës Federale të Gjermanisë, kanë të drejtën në çdo kohë të vetëkontrollohen, ose të kontrollohen nga një përfaqësues, për përdorimin e Fondit të Kredisë dhe të burimeve të Fondit të Garancisë nga ana e BIA-s dhe Huamarrësve Përfundimtarë. BIA do të informojë në lidhje me dokumentet e nevojshme si dhe përmbajtjen e dokumenteve (llogaria e humbjes dhe fitimit, bilancet) në lidhje me situatën ekonomike të projekteve të promovuara. Gjithashtu BIA, zotohet në lidhje me dhënien e huave dhe garancive Huamarrësve Përfundimtarë, për të detyruar Huamarrësin Përfundimtar dhe ndonjë Bankë të angazhuar si ndërmjetëse, për t'iu dhënë të drejtën e kontrollit, të drejtën e inspektimit të kompanisë si dhe detyrimin për të informuar rreth informacionit përkatës. Institucionet e lartpërmendura mund të kontrollojnë ndërmarrjet, e kërkojnë të drejtën për të pasur akses tek librat e Huamarrësve Përfundimtarë dhe tek të tjera dokumenta dhe mund të kërkojnë informacione shtesë.

Neni 13
Garancia e Republikës së Shqipërisë

Si garantues, Qeveria e Republikës së Shqipërisë zotohet me përgjegjësi të plotë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të BIA-s që lindin nga kjo Marrëveshje kundrejt DEG respektivisht Qeverisë Gjermane në përuthje me klauzolën 5 paragrafi I(b) të Notave të I dhe klauzolën e Notave të II.

Neni 14
Arbitrimi

Konfliktet që lindin nga zbatimi i Marrëveshjes së Re të Huasë, duke përfshirë ato konflikte rreth vlefshmërisë së Marrëveshjes së Re të Huasë, do të jenë subjekt i arbitrimit kur palët nuk merren vesh në mënyrë miqësore:

1. Palët nuk bien dakord për një arbitër individual atëhere, mund të formohet një Trup gjykues arbitrar i përbërë nga tre anëtarë që do të caktohen si vijon: një arbitër nga BIA, i dyti DEG dhe i treti (kryetari) nga marrëveshja midis palëve ose, nëse nuk arrihet një marrëveshje brenda 60 ditëve të marrjes së reklamimit të të akuzuarit, me kërkesën e një pale, nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse nga palët nuk cakton arbitrin, atëhere arbitri caktohet nga kryetari.

2. Nëse arbitri i caktuar nuk përmbush detyrimin atëhere një tjetër arbitër caktohet në të njëjtën mënyrë si arbitri i mëparshëm. Ky arbitër i ri do të ketë të gjitha detyrimet dhe autoritetet e arbitrit të mëparshëm.

3. Në përputhje me paragrafin 1 për caktimin e arbitrave, nëse një nga palët reklamon për palën tjetër atëhere konflikti i drejtohet Trupit gjykues arbitrar. Reklamimi duhet të specifikojë llojin e reklamimit, kompensimin e dëshiruar dhe emrin e arbitrit të caktuar nga i akuzuari (I cili duhet të jetë i

autorizuar).

4. Në përputhje me paragrafin 1 për caktimin e arbitrave, i akuzuari duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve të marrjes së reklamimit dhe duhet të njoftojë akuzuesin për emrin e arbitrit të caktuar nga ai vetë (I cili duhet të jetë i autorizuar).

5. Arbitri individual ose kryetari duhet të specifikojnë datën kur do të mblidhet gjykata e arbitrave. Nëse palët vetë nuk kanë specifikuar vendtakimin atëhere kjo caktohet nga Trupi gjykues arbitrar.

6. Trupi gjykues duhet të marrë një vendim përsa i përket kompetencave të tij. Trupi gjykues arbitrar duhet të përcaktojë vetë mënyrën e procedimit, të marrë parasysh principet e përgjithshme të njohura se si duhet të procedojë. Në ndonjë rast palëve iu duhet dhënë mundësia e argumentit gojor në një mbledhje të zakonshme. Trupi gjykues arbitrar gjithashtu mund të marrë vendim në rastin e shkeljes nga njëra palë. Të gjitha vendimet e Trupit gjykues arbitrar kanë nevojë dhe për mendimin e të paktën dy arbitrave.

7. Vendimi arbitrar shkruhet nga Trupi gjykues arbitrar bashkë me arsyet. Firmoset nga të paktën dy arbitra e konsiderohet që do të jetë vendimi arbitrar i Trupit gjykues arbitrar. Çdo pjesëmarrës do të marrë nga një kopje të firmosur. Pas firmosjes së Marrëveshjes së Re të Huasë, palët marrin përsipër për t'iu nënshtruar vendimit arbitrar.

8. Palët duhet të specifikojnë shpërblimin e arbitrave dhe e personave që nevojitem për ekzekutimin e procedurave të arbitrimit. Nëse palët nuk mund të bien dakord për shpërblimin para mbledhjes së parë atëherë, gjykata e arbitrave do të përcaktojë një shpërblim të arsyeshëm. Secila palë mbart në vetvete shpenzimet e tyre që lindin nga procedimet. Shpenzimet e Trupit gjykues arbitrar do të përballohen nga pala e pasuksesshme. Shpenzimet ndahen në mënyrë proporcionale nsëe secila palë rezulton pjesërisht e suksesshme.

9. Vendimet e gjykatës së arbitrave në lidhje me të gjitha çështjet e shpenzimeve të procesit të arbitrimit, janë vendimtare.

10. Palët do të jenë përgjegjës së bashku dhe veç e veç për shpërblimin e personave të përmendura në paragrafin 8.

Neni 15

Kushte të përgjithshme

Nëse DEG nuk bie ndryshe dakord BIA do të:

1.lejojë përfaqësuesit e autorizuar të DEG që të kenë akses tek aktivitetet e saj dhe në çdo kohë gjatë orarit normal të punës sipas një njoftimi të arsyeshëm, n.q.s. BIA nuk i nënshtrohet detyrimeve të Marrëveshjes së Re të Huasë ose nëse DEG ka prova të arsyeshme për të besuar se shërbimi i huave i BIA-s është në rrezik;

2. informojë DEG mennjëherë për ndryshimet e qëllimit të krijimit të shkrirjes ose likuidimit e cila mund të rrezikojë ekzekutimin e projektit.

BIA konfirmon se i ka marrë të gjitha masat që software, hardware dhe aparatet e kontrollit automatik të procesit të mund të operojnë pa gabim gjatë dhe pas vitit 2000.

Neni 16

Kostot dhe shpenzimet

1. Asnjë taksë ose shpenzim publik që do të lindin nga BIA në veçanti kostot e transferimit dhe kostot e dhënies dhe administrimit të huave për ngritjen e bizneseve, nuk mund të financohen nga huatë e akorduara në përputhje me nenin 1 paragrafet 1,2,3 dhe 5.

2. Pas zbritjes së interesit 0.75% në vit pas Nenit 2(1) dhe transferimin e 20% të mbetjes në stokun e kapitalit të Fondit të Garancisë sipas Nenit 7(3), pagesa e ngelur e interesit e marrë nga Humarrësit Përfundimtarë do të përdoret nga BIA për të mbuluar riskun e kursit të këmbimit, kostot e ekzekutimit të projektit përfshi shërbimin, këshillimin dhe konsultimin për Huamarrësit aktualë Përfundimtarë e potencialë, kostot e trajnimit dhe të këshillimit për nëpunësit e BIA-s që merren me projektin dhe kufirin e fitimit. Plus kësaj, BIA është e detyruar që të kryejë si vijon:

- printimin e broshurave të projektit
- masa të tjera për të promovuar projektin p.sh. Reklama të shpeshta në gazeta etj.

Neni 17
Ligji rregullues dhe juridiksioni

1. Marrëveshja e Re e Huasë do të rregullohet në përputhje me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

2. Juridiksioni në lidhje me Marrëveshjen e Re të Huasë i mbetet Trupit gjykues arbitrar të krijuar në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë vendimi i të cilës është përfunduar siç specifikohet në Nenin 14.

Neni 18
Të ndryshme

1. Të gjitha korrespondencat në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen në formë të shkruar, në anglisht tek adresat përkatëse të palëve si vijon:

Për BIA:Per DEG
Banco Italo AlbaneseBelderestrasse 40
Rruga Barrikadave50 Koln (Mungersdorf)
Tirana, AlbaniaFederal Republik of Germany
Tel: 00355-42-33965Telefax: 0049-221-4986-290
Telefax: 00355-42-35700
Për Ministrinë e Financave
Ministria e Financave
Bul: "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Albania
Tel: 00355-42-284 05
Telefax: 00355-42-284 94

Secila palë merr përsipër për ta njoftuar palën tjetër për ndonjë ndryshim të adresave të tyre.

2. Çdo ndryshim ose amendament i kësaj Marrëveshjeje të Re huaje duhet të jetë e shkruar.

3. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje të Re Huaje është ose bëhet e pavlefshme për ndonjë arsye, vlefshmëria e dispozitave të ngelura nuk do të ndikohen. Në këtë rast Palët e Marrëveshjes së Re të Huasë duhet ta zëvendësojnë pa vonesë dispozitën e paefektshme me një dispozitë efektive ligjore që i përafrohet dispozitës së vlefshme.

4. Në rast se DEG dhe/ose Ministria e Financave nuk ushtrojnë të drejta që iu akordohen sipas Marrëveshjes së Re të Huasë, atëhere një mosushtrim i tillë nuk konsiderohet se përbën heqje dorë nga një e drejtë e tillë.

5. Kjo Marrëveshje e Re Huaje do të jetë efektive nëd atën e firmosjes së fundit dhe është efektive për aq kohë sa ka detyrime për t'u paguar DEG ose Ministrisë së Financave.

6. Kjo Marrëveshje e Re Huaje hyn në fuqi në datën e miratimit nga bordi administrues i BIA-s, ky miratim duhet t'iu njoftohet DEG dhe Ministrisë së Financave e shkruar.